



SHTETI NË PASQYRË

Performanca e bazuar në indikatorë

Përgatitur për Forum 2015





**PASQYRA E SHTETIT:
Performanca e Bazuar në Indikatore**

Vlerësimi - Pranverë 2011

Qershor 2011

Copyright © 2011. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurta për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj. pa lejen me shkrim të D4D.

Publikuar nga: Forum 2015
Financuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Tirazhi: 500

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	5
Tabela e Performancës së Përgjithshme	7
Mirënjohjet	8
Hyrje	9
Metodologjia	9
1. EKONOMIA	11
1.1 Performanca Makroekonomike	12
1.2 Tregu i Punës	13
1.3 Stabiliteti Makroekonomik	14
1.4 Zhvillimi i Sektorit Financiar	15
1.5 Korniza Rregullative për Afarizëm	16
1.6 Energjia	17
1.7 Infrastruktura - Transporti dhe Telekomunikacioni	18
Krahasimi Rajonal për Indikatorë të Ekonomisë	19
Analiza e Përgjithshme në Ekonomi	20
Rekomandimet	23
2. QEVERISJA	25
2.1 Qeverisja	26
2.2 Kuvendi i Kosovës	27
2.3 Legjislacioni dhe Mbikëqyrja nga Kuvendi	28
2.4 Ankesat dhe Parashtrësasat Zgjedhore	29
2.5 Ankesat dhe Parashtrësasat Zgjedhore	30
2.6 Partitë Politike	31
2.7 Qeverisja Lokale dhe Decentralizimi	32
2.8 Financat Komunale	33
2.9 Marrëdhëniet Ndër-etnike dhe Kthimi	34
2.10 Media	35
2.11 Shoqëria Civile	36
2.12 Marrëdhëniet e Jashtme dhe Integrimi në BE	37
Krahasimi Rajonal për Indikatorë të Qeverisjes	38
Analizë e Përgjithshme e Qeverisjes	39
Rekomandimet	41
3. SUNDIMI I LIGJIT DHE SIGURIA	43
3.1 Sistemi Gjyqësor	44
3.2 Vlerësimet e Gjyqësorit	45
3.3 Sistemi Korrektues	46
3.4 Anti - Korrupsioni	47
3.5 Të Drejtat e Njeriut	48
3.6 Policia	49
3.7 Siguria Kombëtare	50
Krahasimi Rajonal për Indikatorë të Sundimit të Ligjit	51
Analiza e Përgjithshme në Sundim të Ligjit dhe Siguri	52
Rekomandimet	53
4. ZHVILLIMI SOCIAL	55
4.1 Zhvillimet Demografike	57
4.2 Arsimi	58
4.3 Arsimi i Lartë dhe Bibliotekat	59
4.4 Shëndeti Publik	60
4.5 Sëmundjet dhe Vaksinimet	61
4.6 Çështjet Gjinore	62

4.7 Gratë në Biznes	63
4.8 Mirëqenia Sociale	64
4.9 Shërbimet Publike	65
4.10 Ambienti	66
4.11 Kultura	67
4.12 Sportet	68
4.13 Diaspora dhe Azili	69
Krahasimi Rajonal për Indikatorë të Zhvillimit Social	70
Analiza e Përgjithshme në Zhvillimin Social	71
Rekomandimet	73
Shtojca: Burimet dhe komentet e indikatorëve	74
Ekonomia - Burimet e Indikatorëve	74
Qeverisja - Burimet e Indikatorëve	79
Sundimi i Ligjit - Burimet e Indikatorëve	89
Zhvillimi Social - Burimet e Indikatorëve	95

PËRMBLEDHJE

Më shumë se gjysma e ministrive nuk bëjnë raporte vjetore për punën e tyre, dhe ato që bëjnë, nuk kanë shifra që masin ndikimin e tyre në vend. Me anë të matjes së rezultatit dhe efektit të performancës, matjet janë një lloj trendi global që tani është shndërruar në standard edhe në vendet në zhvillim.

Konkludimet kryesore të këtij studimi janë: (a) mungesa e të dhënave të besueshme, (b) matja jo-adekuate e performancës dhe qeverisje pa objektiva, (c) ekonomia e mbështetur në sektorin publik, (d) numri i lëndëve gjyqësore ka vazhduar të rritet dhe ka mungesë serioze të gjykatësve dhe prokurorëve (e) rritja e sektorit publik është bërë e paqëndrueshme, dhe (f) planifikimi demografik dhe monitorimi duhet të fillohen që të ndihmojnë zhvillimin e politikave efektive të qeverisjes. Mungesa e të dhënave është aq e evidente sa që nuk nevojitet debat më i gjerë se që të dhënat tregojnë në këtë studim, për atë dhe do të përqendrohemi në pesë brengat dhe rekomandimet që prezantohen më poshtë.

Matja jo-adekuate e performancës dhe qeverisje pa objektiva është një prej arsyeve kryesore që pamundësojnë grupet e presionit dhe shoqërisë civile që të kërkojnë llogari nga autoritetet përgjegjëse. Metoda e matjes së indikatorëve nuk merret me strategjitë apo mekanizmat e Qeverisë, me të cilat merren shumë organizata tjera. Metoda e D4D-së me matjen e indikatorëve të performancës përqendrohet vetëm në rezultatet e arritura, pa marrë parasysh mjetet. Për shkak të përqendrimit në rezultate, përkundër nxjerrjes së rekomandimeve, D4D nuk përipiqet të bëjë analizë të detajuar për shkaqet që kanë sjellë tek këto rezultate.

Zhvillimi ekonomik duhet të mbështetet në sektorin privat. Të dhënat ekonomike për vitin 2010 nuk tregojnë ndonjë rritje të vrullshme por vetëm efektet e përfundimit të krizës globale. Përpos faktit se ka një rritje të eksportit të mineraleve për shkak të rritjes së çmimeve në tregun global, bilanci tregtar është përkeqësuar. Rënia e investimeve të jashtme është nivelizuar që tregon se rënia në vitet e kaluara nuk ka qenë ciklike por sezonale dhe strukturore. Duke pasur alternativa për investime në vendet tjera, Kosova mund të tërheqë investime të jashtme vetëm me politika serioze afatgjate që kërkojnë vendime të vështira. Deficiti i buxhetit për vitin 2010 është përkeqësuar krahasuar me vitin 2009 me ngritje të mëdha që janë regjistruara në kategorinë e shpenzimeve publike. Trende pozitive janë vërejtur në disa indikatorë që ndërlidhen me energjinë elektrike si prodhimin e thëngjillit, importimin e energjisë si dhe humbjet e energjisë elektrike dhe inkasimi i energjisë së disponueshme. Brenga kryesore që duhet përkthyer në rekomandim është që të mos mbështetemi në zhvillim përmes shpenzimeve qeveritare por ta kthejmë zhvillimin e sektorit privat në prioritetin më të lartë. Zhvillimi ekonomik i bazuar në shpenzimet publike nuk ka rezultuar me përmirësim në qeverisje, arsimit apo shëndetësi.

Qeveria të hyjë në dietë. Performanca e qeverisjes vitin e kaluar është përkeqësuar në mënyrë drastike. Përderisa qeverisja lokale është përmirësuar, aspektet tjera të qeverisjes ose kanë përjetuar trende negative ose kanë stagnuar. Edhe besimi i shumicës shqiptare dhe komunitetit serb ndaj qeverisë qendrore ka rënë në vitin 2010. Indikatorët e zgjedhjeve kanë vazhduar të degradojnë në vitin 2010, me një nivel të jashtëzakonshëm të parregull-sive dhe monitorim jo-adekuat të procesit të votimit. Numri i ankesave dhe parashtrësive si dhe procedimi i rasteve në prokurori është rritur. Mediat dhe shoqëria civile janë shfaqur më të dobëta se në vitin 2009 apo në vitin 2008, që është evidentuar me indekse të ndryshme. Në përgjithësi, Qeveria duhet të trajtojë shërbimet publike si shërbime për qytetarë dhe të mbajë vetëm aq personel sa është e domosdoshme. Fuqia e tepërt punëtore do të duhej të të ndihmohet dhe trajnohet për t'iu bashkangjitur sektorit privat ku do të ishin më produktiv dhe të mos jenë barrë e buxhetit modest të Kosovës.

Lëndët e hapura në gjykata duhet të zvogëlohen në mënyrë që të rikthehet besimi në sundimin e ligjit në Kosovë, i cili edhe ashtu ka pësuar rënie të madhe në vitin 2010, me përjashtim të sistemit të sigurisë dhe atij korrektues. Numri i rasteve në gjykata ka vazhduar të rritet për më shumë se 10% në krahasim me vitin e kaluar, që mund të jetë shkaktuar nga zvogëlimi i numrit të gjykatësve dhe prokurorëve. Përpos përmirësimeve në burime financiare të gjyqësorit, performanca ose ka pësuar rënie ose ka qëndruar të njëjtë. Të drejtat e njeriut kanë vazhduar të përkeqësohen në dy vitet e fundit, dhe Kosova sërish është radhitur si "pjesërisht e lirë" nga Freedom House që vlerëson se nuk ka pasur përmirësim në të drejtat politike dhe civile. Numri i viktimave të trafikimit dhe përdhunimeve është alarmant. Lufta kundër korrupsioni ka pësuar ngadalësim. Përparim është shënuar në legjisllacion dhe në numrin e rasteve të raportuara, por Agjencia (AKK) ka proceduar 60% më pak raste tek Prokurori Shtetëror sesa një vit më parë. Mirëpo, perceptimi i korrupsionit në qeveri, parti politike dhe biznese është rritur. Siguria publike është përmirësuar e shënuar me më pak vrasje dhe aksidente në komunikacion por numri i vjedhjeve është rritur për më shumë se 10% krahasuar me vitin e kaluar. Është thelbësore që të trajnohen më shumë gjykatës dhe prokurorë që të përballen me kërkesat. Që të jemi në gjendje të monitorojmë performancën e sundimit të ligjit, është me rëndësi që autoritetet të matin kohën mesatare të procedimit të rasteve dhe të përpilojnë objektiva ambicioze si të rrisin performancën në të ardhmen.

Mungesa e planifikimit demografik pengon zhvillimin e politikave të efektshme qeveritare. Ishte e vështirë për të mbledhur të dhënat në kapitullin e zhvillimit social për shkak të mungesës së tyre. Megjithatë, ky kapitull është më i pasuri me indikatorë të performancës (në përgjithësi 129 indikatorë) duke përfshirë arsimin, shëndetin publik, çështjet gjinore, mirëqenien sociale, kulturë, sport dhe diasporën. Indikatorët sasiorë në arsim tregojnë trende pozitive por shumica e ekspertëve besojnë që cilësia ka pësuar rënie. Pak ndryshime vërehen në sektorin e shëndetit publik edhe pse pak të dhëna për 2010 janë bërë publike. Shpenzimet për sektorin shëndetësor kanë rënë lehtë në raport me BPV-në dhe buxhetin e shtetit. Po ashtu ka rënë edhe kënaqshmëria me shërbimet shëndetësore. Vetëm incidenca e sëmundjeve dhe vaksinimeve kanë treguar përmirësime të vogla. Kur vihen në kontekst rajonal, stagnimi në këtë fushë duket edhe më i rëndë pasi që Kosova mbetet prapa gjithë rajonit në Indeksin e Zhvillimit Njerëzor, jetëgjatësisë nga lindja si dhe pritjeve në vitet e shkollimit. Autoritetet duhet të fillojnë me planifikime demografike në nivel qendror dhe komunal duke përfshirë krijimin dhe përcjelljen e objektivave të matshme.

TABELA E PERFORMANCËS SË PËRGJITHSHME

Ekonomia		'08-'09	'09-'10
1.1	Performanca Makroekonomike (12)	▼	▲
1.2	Tregu i Punës (10)	▲	▲
1.3	Stabiliteti Makroekonomik (12)	▼	▼
1.4	Zhvillimi i Sektorit Financiar (12)	▼	◄►
1.5	Korniza Rregullative e Biznesit (13)	▼	▼
1.6	Energjia (12)	▲	▲
1.7	Infrastruktura, Transporti dhe Telekomunikacioni (11)	▲	▲
Governance		'08-'09	'09-'10
2.1	Qeverisja (10)	▼	▼
2.2	Kuvendi i Kosovës (7)	▼	=
2.3	Legjislacioni dhe Mbikëqyrja nga Kuvendi (7)	-	▼
2.4	Administrimi dhe Integriteti i Zgjedhjeve (11)	▼	▼
2.5	Ankesat dhe Parashtresat e Zgjedhjeve (11)	-	▼
2.6	Partitë Politike (7)	-	=
2.7	Qeverisja Lokale dhe Decentralizimi (11)	▲	▲
2.8	Financat Komunale (6)	-	▲
2.9	Marrëdhëniet Ndër-etnike dhe Kthimi (10)	▼	▼
2.10	Media (15)	▼	▼
2.10	Shoqëria Civile (16)	▼	▼
2.11	Marrëdhëniet e Jashtme dhe Integrimi në BE (8)	-	▼
Sundimi i Ligjit		'08-'09	'09-'10
3.1	Sistemi Gjyqësor (10)	▼	▼
3.2	Vlerësimet e Gjyqësorit (14)	-	▼
3.3	Sistemi Korrektues (6)	-	▲
3.4	Anti Korrupsioni (19)	▲	▲
3.5	Të Drejtat e Njeriut (11)	▲	▼
3.6	Policia (12)	-	▲
3.7	Siguria Kombëtare (7)	▼	▲
Zhvillimi Social		'08-'09	'09-'10
4.1	Zhvillimet Demografike (10)	▼	▲
4.2	Arsimi (9)	▲	▲
4.3	Arsimi i Lartë dhe Bibliotekat (8)		▲
4.4	Shëndeti Publik (9)	=	▼
4.5	Sëmundjet dhe Vaksinimi (8)	-	▲
4.6	Çështjet Gjinore (8)	=	=
4.7	Gratë në Biznes (8)	-	=
4.8	Mirëqenia Sociale (6)	-	=
4.9	Shërbimet Publike (8)	=	=
4.10	Ambienti (13)	▲	▼
4.11	Kultura (13)	-	▲
4.12	Sporti (8)	-	▼
4.13	Diaspora dhe Azili (9)	-	=

Mirënjohjet

Si publikimi i parë, ashtu edhe ky i tanishmi, janë përkrahur nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Kosovë (KFOS), të cilëve u jemi mirënjohës si për përkrahjen financiare ashtu edhe për komentet dhe sugjerimet e tyre. Gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë institucionet dhe individët që gjeten kohë t'u përgjigjen kërkesave tona për qasje në të dhëna zyrtare. Disa prej institucioneve më të përgjegjshme që iu përgjigjën kërkesave tona kanë qenë: Enti i Statistikave të Kosovës, Komisioni Qendror Zgjedhor, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Policia e Kosovës, Komisioni i Pavarur i Mediave, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Falënderime të veçanta ju përcjellim edhe përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe ekspertëve që morën pjesë dhe kontribuan në grupet konsultative për këtë publikim ku u dhanë shumë komente dhe sugjerime për përmbajtjen dhe formatin e këtij studimi. Ky falënderim shkon tek organizatat: Qendra për Studime të Sigurisë në Kosovë (KCSS), Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut (YIHR), Agjencia Zvicerane për Zhvillim, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, (UNDP), Zyra e Kryeministrit për Strategji dhe Planifikim, si dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

HYRJJE

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) ka zhvilluar një mjet për përcjelljen e treguesve që në mënyrë objektive masin gjendjen e vendit dhe mirëqenien e shoqërisë. Të dhëna për më shumë se 400 indikatorë janë mbledhur dhe prezantuar në formë lehtë të lexueshme.

Ky është botimi i dytë i treguesve të performancës dhe shoqërohet me disa risi. Janë shtuar të dhënat për 2010 për indikatorët nga botimi i parë dhe është rritur numri i indikatorëve në përgjithësi. Për disa indikatorë, përveç krahasimi kohor me vetveten, performanca e Kosovës gjithashtu është krahasuar edhe me vendet e rajonit.

METODOLOGJIA

Indikatorët janë organizuar në katër kapituj: Ekonomia, Qeverisja, Sundimi i Ligjit dhe Zhvillimi Social. Çdo kapitull përmban grumbuj të indikatorëve të fushës përkatëse (p.sh. Tabela e indikatorëve të Performancës Makroekonomike gjendet brenda kapitullit të Ekonomisë). Secila tabelë përmban mjaft indikatorë që së bashku krijojnë një pikëpamje të gjërë të asaj fushe. Tabelat shfaqin indikatorët e grumbulluar për nga ngjashmëria.

Indikatorët janë nxjerrë nga të dhëna sekondare nga një mori burimesh, pasqyra të fakteve, indekseve, opinioneve publike etj. Më poshtë gjendet një shembull i indikatorëve se si janë të shfaqur në studim:

Në kolonën e parë të secilit indikator gjendet numri rendor që tregon radhitjen e indikatorëve. Kolona e dytë tregon emrin e indikatorit. Kolona e tretë, katërt dhe gjashtë tregojnë të dhënat e viteve të ndryshme (2008, 2009 dhe 2010) respektivisht. Vëni re se të dhënat më të reja të vitit 2010 janë të theksuara me ngjyrë hiri. Kolonat pesë dhe shtatë tregojnë dallimin nga viti në vit dhe tregojnë përmirësimin (▲) ose përkeqësimin (▼) e situatës në atë indikatorë brenda një viti.

Nr.	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08'09)	2010	Dallimi ('09'10)	P
3.1.2.	Numri i gjyqtarëve	284	298	-4.9% ▲	246	-17.4	▼
	Gjyqtar Shqipëtar	251	264	+5.2% ▲	234	-11.3	▼
	Gjyqtar Serbë	18	15	+7.1% ▲	5	-66.7	▼

Figura 1: Indikator i Përformances si është i prezentuar në tableat e nën-kapitujve.

Në fund të çdo tabele gjendet legjenda e simboleve për referim më të lehtë, si dhe numri i faqes ku mund të gjenden burimet për ata indikatorë. Në pjesën më të poshtme të asaj faqe, D4D jep një vlerësim të përgjithshëm për atë fushë që bëhet vlerësimi.

Të dhënat janë mbledhur nga burime dytësore si raporte mujore dhe vjetore të ministrive, agjencioneve të pavarura dhe organizatave ndërkombëtare, raporteve të OJQ-ve, dhe në raste të rralla nga të dhëna që u konsideruan si kredibile në media. Në disa raste, D4D ka kalkuluar të dhënat për disa indikatorë nga të dhëna ekzistuese.

Kur të dhënat nuk janë të qasshme për një indikatorë specifik në atë kuti është shënuar N/A (si p.sh. Indeksi i Demokracisë i UNDP-së për vitin 2008 dhe 2009 pasi që UNDP ka filluar ta përpilojë këtë indeks që nga viti 2010). Në rast kur disa të dhëna nuk janë publikuar deri në momentin kur ky raport ka hyrë në shtyp, kjo është shënuar me (-)(p.sh. Shkalla e papunësisë si % e fuqisë punëtore për 2010)

	Indikatorët	Burimi	Komentet
3.1.2.	Numri i gjyqtarëve Gjyqtar Shqipëtar Gjyqtar Serbë	OSBR Përbërja gjinore e gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë (2010) ABA Nisma e sundimit të ligjit. Indexi i Reformimit Gjyqësor në Kosovë.	Përderisa numri total i gjykatësve dhe prokurorëve është marrë nga OSBE, numri i gjykatësve me përkatësi shqiptare dhe serb është marrë nga ABA Nisma e Sundimit të Ligjit.

Figura 2: Si mund të gjenden burimet e indikatorëve

Referencat e indikatorëve gjenden në pjesën e fundit të publikimit në shtojcë të veçantë. Indikatorët mund të gjenden lehtë në shtojcën e burimeve duke iu referuar numrit rendor (p.sh. 3.1.2) që gjendet në kolonën e parë. Kolona e tretë në pjesën e referencës tregon burimin e saktë se nga është marrë e dhëna për atë indikatorë, ndërsa kolona e katërt jep sqarime të më tutjeshme për atë indikatorë.

Disa prej indikatorëve janë vënë përbri me të dhënat e shteteve të rajonit, po ashtu një risi e këtij botimi. Të dhënat për pesë shtete të rajonit (Shqipëri, Bosnje & Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi) janë prezantuar si dhe kalkulimet e mesatares së rajonit që është krahasuar me të dhënat për Kosovën. Vlerësimi për Kosovën, pozitiv apo negativ, është dhënë varësisht nëse kalon apo është nën mesatares së e rajonit.

Të dhënat dhe shifrat në vete tregojnë diçka të fuqishme mirëpo një analizë e këtyre të dhënave shton thellësinë e kuptimit dhe krijon mundësi më të mirë për të nxjerrë konkludime. Prandaj, çdo kapitull në këtë botim është i pasuar me një analizë që shkon përtej shifrave dhe tregon marrëdhëniet në mes të të dhënave të treguesve të ndryshëm në atë kapitull. Kjo pjesë vë indikatorët në kontekst dhe tregon rëndësinë për progresin e përgjithshëm të Kosovës. Analiza po ashtu është ndihmuar nga diskutimet me ekspertë të këtyre lëmive në grupet e diskutimit që janë organizuar nga D4D si dhe rekomandime që D4D beson janë me rëndësi të lartë për tu adresuar në zhvillimin e shtetit.

1. Ekonomia

1.1 Performanca Makroekonomike

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
1.1.1	Shkalla e rritjes reale e BPV-së (%)	5.4	2.9	-2.5 ▼	4.0	+1.1	▲
1.1.2	Shkalla e rritjes reale e BPV -së për kokë banori (%)	3.8	2.5	-1.3 ▼	3.0	+0.5	▲
1.1.3	Eksportet (si % e BPV-së)	5.6	4.2	-1.4 ▼	7.1	+2.9	▲
1.1.4	Importet (si % e BPV-së)	49	46.7	-2.3 ▲	52.1	+5.4	▼
1.1.5	Bilanci Tregtar (si % e BPV-së)	-43.3	-42.5	-0.8 ▲	-45	-2.5	▼
1.1.6	Eksportet e mallrave (ndryshimi vjetor, %)	23	-25	-2 ▼	77.8	+102.8	▲
1.1.7	Importet e mallrave (ndryshimi vjetor, %)	22	-2.6	-24.6 ▲	10.8	+13.4	▼
1.1.8	Shkalla e mbulimit të eksporteve nga importet (%)	12	8	-4 ▼	13.7	+5.7	▲
1.1.9	Remitancat (si % e BPV-së)	13.9	13	-0.9 ▼	12.4	-0.6	▼
1.1.10	Transferet Zyrtare të Jashtme (si % e BPV-së)	7.5	6.4	-1.1 ▼	8.7	+2.3	▲
1.1.11	Bilanci i llogarisë rrjedhëse (si % e BPV-së)	-15.4	-16.2	+0.8 ▼	-17.3	+2.2	▼
1.1.12	Investimet e Huaja Direkte (si % e BPV-së)	9.5	5.6	-3.9 ▼	7.6	+2.0	▲

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – [Burimet/komentet të kësaj tableje gjenden në faqen 74.](#)

Nota e Përgjithshme: Përmirësim (▲)

1.2 Tregu i Punës

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
1.2.1	Shkalla e Papunësisë (% of labour force)	47.4	45.4	-2 ▲	-	-	-
1.2.2	Shkalla e papunësisë së rinisë (%)	73	73	0=	-	-	-
1.2.3	Shkalla e papunësisë së femrave (%)	59.6	56.4	-3.2▲	-	-	-
1.2.4	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (%)	46	47.7	+1.7▲	-	-	-
1.2.5	Shkalla e pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore (%)	26.1	28.7	+2.6▲	-	-	-
1.2.6	Shkalla e punësimit (%)	24.1	26.1	+2▲	-	-	-
1.2.7	Regjistri publik i të papunësuarve (numër)	335,945	338,895	+0.9%▼	335,260	-1.07%	▲
1.2.8	Paga mujore mesatare (Euro)	247	N/A	-	292	+18%	▲
1.2.9	Sektori publik (Euro)	249	N/A	-	268	+7.6%	▲
	Sektori Privat (Euro)	243	N/A	-	303	+27.7%	
1.2.10	Paga mesatare më e ulët (Gjilan, Euro)	230	N/A	-	236	+2.6%	▲
	Paga mesatare më e lartë (Prishtina, Euro)	255	N/A	-	338	+32.5%	

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – Burimet/komentet të kësaj tabele gjenden në faqen 74.

Nota e Përgjithshme: Përmirësim (▲)

1.3 Stabiliteti Makroekonomik

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
1.3.1	Të ardhurat publike (EUR million)	989.1	1,149	+16% ▲	1,194.5	+3.9%	▲
1.3.2	Dogana (EUR million)	604.2	634.1	+5% ▲	699.4	+10.2%	▲
	Administrata tatimore (EUR million)	200.8	181.6	-9.5% ▼	194.2	+6.9%	
1.3.3	Shpenzimet publike (EUR million)	963.4	1,180	+22% ▲	1,287.3	+9.0%	▼
1.3.4	Paga (EUR million)		268.9		316.2	+17.6%	▲ ▼
	Mallrat dhe Shërbimet (EUR million)	-	173	-	186.7	+7.9%	
	Subvencionet dhe Transferet (EUR million)	-	282	-	253.4	-10.4%	
	Shpenzimet Kapitale (EUR million)	-	375	-	459.3	+22.5%	
1.3.5	Bilanci Primar Buxhetor (si % e BPV-së)	-0.02	-0.68	-0.66 ▼	-2.3	-1.6	▼
1.3.6	Bilanci i Përgjithshëm (si % e BPV-së)	0.0	-0.86	-0.86 ▼	-	-	-
1.3.7	Borxhi i Qeverisë (si % e BPV-së)	-	17.8	-	17.7	+0.1	=
1.3.8	Pagesa e Interesit (si % e BPV-së)	0.0	0.2	+0.2 ▼	0.2	0.0	=
1.3.9	Barra e taksave për ekonominë (si % e BPV-së)	21.6	21.1	+0.5 ▲	24.1	0.3%	▼
1.3.10	Indeksi i çmimeve të konsumit (IQK) (mesatarja %)	9.4	-2.4	-11.8 ◀▶	3.5	+5.9	▼
1.3.11	IQK fundi i periudhës (%)	0.5	0.1	-0.4 ◀▶	6.6	+6.5	▼
1.3.12	Deflatori i BPV-së (%)	7	-3.4	-10.4 ◀▶	-	-	-

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – [Burimet/komentet të kësaj tableje gjenden në faqen 75.](#)

Nota e Përgjithshme: Përkeqësim (▼)

1.4 Zhvillimi i Sektorit Financiar

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
1.4.1	Asetet Bankare (% of GDP)	46.9	56.9	+10 ▲	59.6	+2.7	▲
1.4.2	Asetet e huaja neto (në milion Euro) – nga e cila depozita dhe letra me vlerë (në milion Euro)	1,593 1,456	1,700 1,634.4	+6.7%▼ +12.2%▼	1,995.2 1,783	+17.3% +9.1%	▼
1.4.3	Depozitat (si % e BPV-së)	37.52	45.11	+7.6▲	47	+1.9	▲
1.4.4	Rritja vjetore e depozitave (%)	26.3	20.8	-5.5▼	11.0	-9.8	▼
1.4.5	Kreditë (si % e BPV-së)	30.75	33.32	+2.6▲	35.4	+2.1	▲
1.4.6	Norma vjetore e rritjes së kredisë (%)	32.6	8.9	-23.7▲	13.2	+4.3	▲
1.4.7	Shpërndarja e interesit (%)	9.4	10,1	+0.7▼	10.9	+0.8	▼
1.4.8	Shkalla e kredive të këqija (%)	3.3	4.3	+1▼	5.2	+0.9	▼
1.4.9	Kthimi nga asetet mesatare (%)	2.6	1.3	-1.3▼	-	-	-
1.4.10	Kthimi nga kapitali mesatar (%)	26.6	13.2	-13.4▼	18.9	+5.7	▲
1.4.11	Raporti kredi/depozita (%)	82	74	-8▼	75.3	+1.3	▲
1.4.12	Raporti i aseteve likuide ndaj aseteve totale (%)	30.7	32.3	+1.6▲	-	-	-

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – Burimet/komentet të kësaj tableje gjenden në faqen 76

Nota e Përgjithshme: Ndryshueshëm (◀▶)

1.5 Korniza Rregulative për Afarizëm

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
1.5.1	Lehtësia e të bërit biznes (renditja)	107	113	+6▼	119	+6	▼
1.5.2	Fillimi i një biznesi (renditja)	156	164	+8▼	163	-1	=
1.5.3	Përpjekja për marrjen e lejes së ndërtimit (renditja)	173	176	+3▼	173	-3	=
1.5.4	Punësimi i punëtorëve (renditja)	32	34	+2▼	-	-	-
1.5.5	Regjistrimi i pasurisë (renditja)	60	68	+8▼	65	-3	=
1.5.6	Marrja e kredisë (renditja)	41	43	+2▼	32	-11	▲
1.5.7	Mbrojtja e investitorëve (renditja)	171	172	+1▼	173	-1	=
1.5.8	Pagesa e taksave (renditja)	49	50	+1▼	41	-9	▲
1.5.9	Tregti përtej kufirit (renditja)	129	132	+3▼	130	-2	=
1.5.10	Zbatimi i kontratave (renditja)	156	157	+1▼	155	-2	=
1.5.11	Mbyllja e biznesit (renditja)	28	28	0=	31	+3	=
1.5.12	Regjistrimi i korporatave						
	Regjistrimi i korporatave të reja (numër)	7,111	7,505	+5.5% ▲	7,729	+3%	▲
	Korporatat e mbyllura (numër)	943	1,136	+20% ▼	1,363	+20%	▼
1.5.13	Shkalla në mes të korporatave të reja dhe të mbyllura (%)	7.5	6.6	-0.9▼	5.7	-0.9	▼

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – [Burimet/komentet të kësaj tablele gjenden në faqen 76.](#)

Nota e Përgjithshme: Përkeqësim (▼)

1.6 Energjia

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
1.6.1	Prodhimi i thëngjillit (milion tonelata)	7,84	7,87	+0.4% ▲	7,95	+1%	▲
1.6.2	Konsumi i thëngjillit (milion tonelata)	-	8,00	-	8,46	+5.7%	▲
1.6.3	Prodhimi i energjisë elektrike (GW orë)	4,505.8	5,260	+16.7% ▲	5,481	+4.20%	▲
1.6.4	Gjenerimi i energjisë nga hidrocentralet (GW orë)	75.7	88.7	+17.2% ▲	115.5	+30.2%	▲
1.6.5	Konsumi i energjisë elektrike (GW orë)	2,941.0	3,200.7	+8.9% ▲	3,480.3	+8.7%	▲
1.6.6	Importimi i energjisë elektrike (GW orë)	647.5	767.5	+18.5% ▼	816.6	+6.4%	▼
1.6.7	Eksportimi i energjisë elektrike (GW orë)	235.0	113.9	- 51.5% ▼	350.6	+207.1%	▲
1.6.8	Bilanci tregtar (GW orë)	-412,5	-653,6	+58.4% ▼	-466	-28.7%	▲
1.6.9	Humbjet (në %)	44.1	35.45	- 9% ▲	34.6	-2.4% (3/4 of 2010)	▲
1.6.10	Inkasimi (në mil. Euros)	134.6	160	+18% ▲	175.7	+9.8%	▲
1.6.11	Inkasimi (si % e energjisë së faturuar)	76	81	+5 ▲	-	-	-
1.6.12	Inkasimi i energjisë së përgjithshme në dispozicion (%)	61	64	+3 ▲	-	-	-

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – [Burimet/komentet të kësaj tabele gjenden në faqen 78.](#)

Nota e Përgjithshme: Përmirësim (▲)

1.7 Infrastruktura - Transporti dhe Telekomunikacioni

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
1.7.1	Rrjeti rrugor (kryesor + rajonal, km)	1,925.1	1,925.1	0=	-	-	-
1.7.2	Përpjesëtimi për rrugë paasfaltuar në të asfaltuar	15.5	15.4	+0.1=	-	-	-
1.7.3	Trafiku i pasagjerëve me hekurudha	399,221	374,504	-6.2%▼	376,770	+0.6%	▲
1.7.4	Trafiku i mallrave (neto tona)	823,045	911,830	+10.8%▲	1,128,658	+23.8%	▲
1.7.5	Numri i fluturimeve të kryera	4,828	5,709	+18.2%▲	5,541	-2.9%	▼
1.7.6	Gjithsej udhëtarë (milion pasagjerë nga AP)	1.13	1.19	+5.4%▲	1.30	+9.2%	▲
1.7.7	Turistë Kosovarë Ndërkombëtarë	44,294	88,949	-50.2%	79,045	-26%	▼
		19,678	52,631	-62.6%	44,662	-25%	
		24,616	36,318	-32.2%	34,382	-26%	
1.7.8	Linjat fikse telefonike (vetëm PTK)	78,869	88,877	+12.7%▲	-	-	-
1.7.9	Abonimet Mobile Telefonike	1,159,950	1,463,609	+26.2%▲	1,754,252	+32%	▲
1.7.10	Shfrytëzuesit e internetit	110,879	125,949	+13.6 %▲	-	-	-
1.7.11	Abonimet për Internet kabllor (vetëm IPKO dhe PTK)	93,847	118,749	+26.53%▲	102,311 (3/4 of 2010)	-	▼

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – Burimet/komentet të kësaj tablele gjenden në faqen 78.

Nota e Përgjithshme: Përmirësim (▲)

Krahasimi Rajonal për Indikatorë të Ekonomisë

Nr	Indikatorët	2010 Kosovë	Mes. Rajon	Dallimi	P	SHQ	B&H	KRO	MAQ	MLZ	SRB
1.1.1	Shkalla e rritjes reale e BPV-së (%)	4.0	1.71	2.3	▲	4.1	0.9	-1.2	0.7	1.1	1.8
1.1.5	Bilanci Tregtar (si % e BPV-së)	-45	-27.0	-18	▼	-23.4	-26.2	-12.9	-21.6	-43.5	-16.5
1.1.11	Bilanci i llogarisë rrjedhëse (si % e BPV-së)	-17.1	-10.4	-6.7	▼	-12	-5.3	-1.5	-2.5	-26	-7.3
1.1.12	Investimet e Huaja Direkte Direkte (si % e BPV-së)	7.6	5.6	2.0	▲	5.9	0.1	1.3	3.2	17.9	3.0
1.2.1	Shkalla e Papunësisë (% e fuqisë punëtore)	45.4 (2009)	24.4	21.0	▼	13.7	42.7	11.8	32.1	12.1	20
1.3.6	Bilanci i Përgjithshëm i Qeverisë (si % e BPV-së)	-2.8	-3.6	1.2	▲	-3.0	-3.8	-5.7	-2.5	-3.0	-4.5
1.3.7	Government Debt (si % e BPV-së)	17.7	39.2	-21.5	▲	59.4		40.9	34.0	42	41.4
1.3.10	Borxhi i Qeverisë (IQK) (mesatarja %)	3.5	3.22	0.38	▼	3.6	2.1	1.0	1.6	0.5	10.3

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – Shiko burimet duke iu referuar numrit të indikatorëve.

Analiza e Përgjithshme në Ekonomi

Në nëntor të vitit 2010, Enti Statistikor i Kosovës (ESK) ka prezantuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor (BPV) që përfshijnë periudhën prej 2004 deri në 2009. Duke u bazuar në këto të dhëna, shkalla e rritjes ekonomike në 2009 ka qenë 2.9%, më e ulët sesa niveli 4,0% sa ka qenë e parashikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Ministria e Financave (MEF). Për 2010, parashikimet e fundit të FMN-së të publikuara në raportin e organizatës për Parashikimet Ekonomike Botërore (World Economic Outlook) në prill 2011, kishin pritje për një rritje reale prej 4%. Sipas FMN-së, kjo rritje pritej nga konsumi dhe shpenzimet e investimeve nga sektorët publik dhe privat. Megjithatë, shqetësimet po shtohen lidhur me atë se në çfarë niveli do të vazhdojë rritja ekonomike që bazohet në ngritjen e shpenzimeve të qeverisë, në vend se kjo rritje të gjenerohet më shumë nga investimet dhe konsumi i sektorit privat.

Sipas statistikave të tregtisë për vitin 2010, eksporti i mallrave është ngritur kryesisht nga kërkesa e madhe nga jashtë dhe rritja e çmimeve të metaleve. Edhe pse nga një bazë e ulët, në vitin 2010 eksportet e mallrave u rriten për 78%. Mirëpo, edhe pse ka pasur një ngritje të madhe, deficitin tregtar është zgjeruar në terme absolute prej €1.770 milion në 2009 në EUR 1.851 milion në 2010. Struktura e eksporteve në Kosovë është e dominuar kryesisht nga metalet bazë (produktet e hekurit, çelikut, plumbit, nikelit dhe zinkut), të cilat përbëjnë 63% të eksportit të përgjithshëm. Vlera e eksportit të metaleve bazë është dyfishuar në vitin 2010 duke arritur në €185,2 milion. Ngritja në vlerë e eksporteve reflekton prodhimin më të madh si dhe rritjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Përderisa partneri kryesor eksportues i Kosovës është Italia që përbën 27% të eksporteve totale, partnerët kryesor për import në Kosovë vazhdojnë të jenë shtetet e CEFTA-s, më konkretisht Maqedonia dhe Serbia me 14,7% dhe 12% respektivisht.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse, bazuar në të dhënat e publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është më i lartë për 28% në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (prej €534,4 milion në 2009 në €688 milion në 2010), kryesisht për shkak të importeve më të larta të mallrave dhe shërbimeve si dhe të rritjes së pagesave për shërbime ndërtimore, posaçërisht në çerekun e dytë të vitit. Krahasuar me deficitin tregtar të mallrave, deficitin i llogarisë rrjedhëse është më i vogël për shkak të transfereve të mëdha nga jashtë në formë të remitançave dhe donacioneve. Sipas të dhënave të shpallura nga BQK, gati që nuk ka ndryshim të remitançave të transferuara në vitin 2010 dhe atyre të vitit të kaluar (prej €505,6 milion në €511,5 milion). Prej shumës së përgjithshme të remitançave, kontributi më i madh vazhdon të vjen nga Gjermania, Zvicra, Italia dhe Austria.

Përkundër pritjeve të shumta, Investimet e Huaja Direkte (FDI), qëndrojnë në nivel të ulët si në vitin e kaluar. Përkundër rënies në 2009, investimet ishin paraparë të rriten për 16% në 2010 (prej €300 milion në 2009 në €350 milion në 2010). Sipas të dhënave preliminare nga BQK, në 2010, shuma e investimeve në Kosovë ka arritur rreth €314,3 milion deri në fund të vitit. Shtetet si Sllovenia, Gjermania, Austria dhe Zvicra janë kontribuesit më të mëdhenj të investimeve në Kosovë.

Deri në prill të vitit 2011, ESK nuk ka publikuar rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) e cila është bërë në çerekun e fundit të vitit 2010. Duke u bazuar në regjistrin e menaxhuar nga Shërbimet e Punësimeve Publike (SHPP) pranë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë viti 2010, numri i të regjistruarve si të papunë ka mbetur i njëjtë, rreth 335.000. Në fund të dhjetorit 2010 kanë qenë 335.260 kosovarë të regjistruar si të papunësuar. Ky numër shënon një rënie të vogël në krahasim me të dhënat e raportuara në dhjetor 2009 (338.895). Mirëpo, është e rëndësishme të theksohet që sistemi i regjistrimit të papunësisë (SHPP) është i fryrë (dhe si pasojë jo kredibil) me shumë persona të cilët nuk kërkojnë punë në mënyrë aktive, apo të cilët janë duke punuar në tregun jo-formal, përderisa ka shumë të papunësuar të cilët nuk janë të regjistruar në SHPP.

Duke u bazuar në të dhënat preliminare nga Ministria e Financave, deficitin buxhetor është përkeqësuar në 2010 në krahasim më vitin 2009 prej €31 milion në €93 milion. Ky përkeqësim ka ndodhur për shkak se në terma nominal shpenzimet publike janë rritur me ritëm më të shpejtë sesa të ardhurat publike në 2010 (9% kundrejt 2.9%). Rritje domethënëse është regjistruar në

të gjitha kategoritë e shpenzimeve publike në vitin 2010 përveç në kategorinë e transfereve dhe subvencioneve. Kategoria e pagave dhe pagesave është ngritur për 17,6% (prej €269 milion në €316 milion), mallrat dhe shërbimet prej 7,9% (nga €173 milion në €186,7 milion), dhe rritja më e madhe është regjistruar në kategorinë e shpenzimeve kapitale prej 22,5% (nga €375 milion në €459,3 milion). Në anën tjetër, kategoria e subvencioneve dhe e transfereve ka rënë për 10,4% (nga €282 milion në 2009 në €253,4 milion në 2010).

Për shkak të zgjedhjeve të hershme dhe zhvillimeve tjera politike, Kosova nuk ka qenë në gjendje të miratojë buxhetin e vitit 2011 në vitin paraprak. Në këtë kontekst, Kuvendi i Kosovës ka miratuar buxhetin për vitin 2011 në fund të muajit mars 2011. Duke u bazuar në buxhetin e vitit 2011, deficitin buxhetor (duke mos përfshirë mbështetjen direkte buxhetore) parashihet të përkeqësohet edhe më tej dhe të arrijë në €226 milion (apo 4,7% të BVP-së). Dy faktorë kontribues për këtë deficit më të madh buxhetor janë: (i) shpenzimet e mëdha për projektin e ndërtimit të autostradës Morine – Merdare dhe (ii) shpenzimet për rritjen e pagave. Buxheti i vitit 2011 përfshin rritjen e pagave të shërbyesve civil në mesatare prej 27%. Ky vendim qartazi devijon nga përkushtimet e bëra në Marrëveshjen me FMN-në (Stand-by Agreement), dhe mund të shpie në përkeqësimin e konkurrencës së çmimeve, ndërsa mbetet të shihet nëse ka efekte të pafavorshme në krijimin e vendeve të punës në sektorin privat.

Inflacioni është përshpejtuar nga gjysma e dytë e vitit të kaluar dhe ka arritur nivel të lartë prej 10,8% (vit-më-vit) kah fundi i marsit 2011. Ngritja e çmimeve është vërejtur kryesisht në çmimet e ushqimit dhe energjisë, duke kontribuar në 7,1% përkatësisht 1,1%. Pasi që produktet e ushqimit ende përbëjnë pjesën më të madhe të shportës së konsumit, niveli i përgjithshëm i çmimeve parashikohet natyrshëm të ndikohet nga rritja e çmimeve të këtyre produkteve. Çmimet e ushqimit bazik sikurse buka, drithërat, vajrat dhe yndyra vazhdojnë të ngriten, duke ndikuar në mënyrë disproporcionale tek pjesët e varfra të popullatës. Më shumë se 93% e mallrave dhe shërbimeve të shportës nga Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (CPI) tregojnë që çmimet ushtrojnë presion që shpie drejt inflacionit. Presioni i përgjithshëm që shpie drejt inflacionit po ashtu mund të ketë qenë i ndikuar nga vendimi i fundit i qeverisë për ngritjen e konsiderueshme të pagave të shërbyesve civil.

Asetet e sektorit financiar në Kosovë (përjashtuar asetet e BQK-së) kanë shënuar rritje vjetore prej 13,7%, kryesisht nëpërmjet rritjes së aseteve të sektorit bankar dhe fondit të pensioneve. Rritja e depozitave është ngadalësuar për 11% (nga viti në vit) në dhjetor 2010 duke u krahasuar me rritjen vjetore prej 21% në dhjetor 2009. Niveli i rritjes së depozitave për amvisëri ka qëndruar stabil në rreth 25% (nga viti në vit), duke kompensuar një shumë të konsideruar të zvogëlimit të depozitave shtetërore (të ndërmarrjeve publike). Në anën tjetër, rritja e kredisë ka qëndruar në vlerë dyshifrore dhe ka qenë 13,2% në dhjetor të vitit 2010, një rritje më e madhe në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Kreditë për ndërmarrje janë rritur për 8,4% (ka qenë 4,8% në dhjetor 2009) duke shënuar përmirësim të mundësive për huadhënie në krahasim me vitin 2009. Mirëpo, krahasuar me huadhënien tek amvisëritë (që është rritur për 27,2%) kjo tregon që huadhënia tek ndërmarrjet nuk është liruar në masë të plotë. Një indikator tjetër i rëndësishëm për efikasitetin e sektorit bankar është shkalla e kredive të këqija. Ky indikator është përkeqësuar dhe është rritur prej 4,3% në fund të viti 2009 në 5,2% në fund të 2010.

Shtrirja e nivelit të kamatës në mes të kredive dhe depozitave është rritur gati nga fillimi i vitit prej 10,9 pikë të përqindjes në 10,1 pikë të . Përderisa mesatarja e nivelit të interesit për kredi është ngritur pak prej 14,4% në dhjetor 2009 te 14,6% në 2010, mesatarja e nivelit të kamatave në depozita ka shënuar rënie në 3,7% në dhjetor 2010 prej 4,3% në dhjetor të vitit 2009. Si rezultat, përfitimi neto i sektorit bankar ka shënuar rritje prej 44% (nga viti në vit) në €36,6 milion në fund të vitit 2010 (kryesisht bazuar në ngritjen e të ardhurave prej interesit).

Bazuar në raportin e Bankës Botërore e të Bërit Biznes të publikuar në 2011 por me të dhënat e vitit 2010, Kosova është radhitur në vendin e 119-të në indeksin për lehtësim e të bërjes biznes, 6 vende më poshtë se një vit më parë. Radhitja e ulët e indeksit për lehtësim të bërjes së biznesit do të thotë që ambienti rregullativ nuk është nxitës për zhvillim të biznesit. Pozicioni i përkeqësuar i Kosovës nuk është si rezultat i politikave të pafavorshme të ndërmarrja në 2010 por më saktë si rezultat i asaj që nuk ka pasur zhvillime pozitive gjatë kësaj periudhe, deri sa shtetet tjera kanë ndërmarrë nisma për të përmirësuar ata indikatorë. Indikatorët që lidhen me

fillimin e bizneseve, lejet për ndërtim, mbrojtja e investitorëve, tregtia përtej kufijve dhe zbatimin e kontratave janë radhitur shumë ulët. Viti 2010 ka qenë po ashtu viti me mbyllje me të shumta të bizneseve (në përgjithësi 1.363 biznese janë mbyllur). Pika më e lartë e mbylljes së bizneseve është regjistruar në çerekun e parë të vitit 2010.

Infrastruktura e zhvilluar mirë është kusht themelor për zhvillim ekonomik, sikurse është po ashtu një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e lokacionit dhe sektorëve që mund të zhvillohen. Trende pozitive janë vërejtur në shumë indikatorë lidhur me energjinë, siç është prodhimi i qymyrit, importi i energjisë si dhe zvogëlimi nga humbjet në energji dhe grumbullimin e energjisë totale. Prodhimi i qymyrit është rritur për 1,1%, ndërsa prodhimi i energjisë është rritur për 4,6%. Prej 5.596,4 GWh të energjisë e cila është prodhuar në 2010, 97,9% është prodhuar në termocentrale dhe 2,1% në hidrocentrale. Në anën tjetër, në vitin 2010, Kosova ka konsumuar rreth 3.480,3 GWh energji ose 8,7% më shumë sesa vitin e kaluar. Me qëllim që të përmbushë kërkesën në rritje, Kosova në 2010 ka importuar 816 GWh, 6,3% më shumë se në vitin 2009. Përkundër trendeve pozitive të shënuara në shumë indikatorë të energjisë, nuk ka pasur përparim në projektin e Termocentralit Kosova e Re, Projektit të Hidrocentralit në Zhur dhe hidrocentraleve tjera më të vogla.

Ngritje domethënëse është shënuar në trafikun e transportit hekurudhor që tregon se më shumë mallra janë duke u transportuar me tren. Mirëpo, trafiku hekurudhor për pasagjerë nuk ka pasur përmirësim. Është me rëndësi të theksohet që numri i pasagjerëve në trafikun ajror ka shënuar rritje edhe pse ka pasur një rënie në numrin total në trafikun e fluturimeve të bëra gjatë vitit 2010. Shfrytëzimi i infrastrukturës së telekomunikimit ka shënuar përmirësim gjatë vitit 2010, kryesisht në abonime të telefonisë mobile si dhe në abonime të internetit, derisa për përdoruesit e internetit nuk ka të dhëna ende për vitin 2010.

Recommendations

Modeli i tashëm i zhvillimit ekonomik në Kosovë i mbështetur në buxhetin shtetëror ka nevojë të modifikohet: Në dy vitet e fundit, Qeveria ka mbështetur zhvillimin ekonomik kryesisht nëpërmjet rritjes së shpenzimeve publike. Shpenzimet publike gati janë dyfishuar në mes të viteve 2007 dhe 2010 (prej €656 milion në €1.287,3 milion). Mirëpo, Qeveria nuk mund të mbështesë zhvillimin ekonomik në këtë mënyrë vazhdimisht. Ka kufizime në atë se sa mund të vazhdojë qeveria të shërbejë si bartës i vetëm i zhvillimit ekonomik. Prandaj, promovimi i sektorit privat si dhe thithja e investimeve të huaja duhet të bëhen prioritet kryesor i qeverisë. Qeveria ka nevojë të përqendrohet në adresimin e çështjeve për klimë të investimeve që janë identifikuar në sondazhe të ndryshme të cilat paraqesin pengesat më serioze në zhvillim të biznesit dhe në promovimin e masave kryesore për të inkurajuar hapjen dhe zgjerimin e kompanive private.

Vëmendje më të madhe për stabilitet të qëndrueshëm fiskal: Deficiti buxhetor është përkeqësuar prej 31 milionë euro në vitin 2009 në 93 milionë në 2010, dhe bazuar në buxhetin e parashikuar për 2011, bilanci buxhetor (përfshirë mbështetjen direkte buxhetore) parashihet të përkeqësohet edhe më tej dhe të arrijë në 226 milionë euro (ose 4,7% të BPV-së). Janë dy rreziqe potenciale lidhur me buxhetin e vitit 2011. E para është se financimi nga jashtë prej 167 milionë eurosh është shtuar në buxhet në formë të mbështetjes direkte buxhetore, e cila është lidhur me pritjet për vlerësimin pozitiv të shqyrtimeve të FMN-së, dhe e dyta ka të bëjë me të ardhurat nga privatizimi i ndërmarrjes publike, Post-Telekomit të Kosovës. Njëra nga këto dy supozime tani më nuk mund të materializohet, dhe Kosova do të i shtjerre të gjitha bilanci bankare pozitive të qeverisë deri në fund të vitit, e cila e vë në rrezik të madh stabilitetin dhe qëndrueshmërinë fiskale për 2011 si dhe për vitet në vijim.

Institucionet qeveritare duhet të analizojnë kujdesshëm trendet negative të sektorit financiar. Nivel i ulët i rritjes në depozita dhe huadhënie tek ndërmarrjet është fakt shqetësues pasi që automatikisht kthehet në barrierë për rritje të mëtejme të BPV-së e cila ndikon në kërkesën e përgjithshme nëpërmjet konsumit dhe investimeve, si dhe ofertës së përgjithshme nëpërmjet investimeve. Një indikator tjetër i rëndësishëm për efikasitetin e sektorit bankar janë kreditë e këqija, të cilat kanë shënuar rritje nga 4,3% në fund të vitit 2009 në 5,2% në fund të viti 2010. Shtrirja e nivelit të kamatës në mes të kredive dhe depozitave ka shënuar rritje për gati 1 përqind. Të gjithë këta indikatorë kërkojnë vëmendje të kujdeshme prej institucioneve qeveritare, që të analizojnë nga afër dinamikën e kërkesës dhe ofertës të sektorit financiar dhe të identifikojnë ngeçjet. Këto ngeçje mund të gjenden në nivel të ofertës dhe kërkesës për financa, në infrastrukturën e tregut (financiar) dhe nivelin e shërbimeve, si dhe në nivelin e politikave, legjislationit, rregulloreve, dhe kornizave institucionale siç është sigurimi i të drejtave pronësore, zbatimi i të drejtave të kreditorëve. Në fund, institucionet qeveritare duhet të krijojnë politika si dhe të ndërmarrin veprime të nevojshme për të zgjidhur problemet kryesore dhe barrierat e politikave për të zhvilluar më tej sektorin financiar.

Institucionet qeveritare duhet të analizojnë kujdesshëm trendet negative të treguar në shumë indikatorë të sektorit financiar. Nivel i ulët i rritjes në depozita dhe rritja e pakët e huadhënies tek ndërmarrjet është fakt shqetësues pasi që automatikisht kthehet në barrierë për rritje të mëtejme të BPV-së e cila ndikon në kërkesën e përgjithshme nëpërmjet konsumit dhe investimeve, si dhe ofertës së përgjithshme nëpërmjet investimeve. Me tej, indikator tjetër i rëndësishëm për efikasitetin e sektorit bankar janë kreditë e këqija. Kreditë e këqija kanë shënuar rritje nga 4,3% në fund të vitit 2009 në 5,2% në fund të viti 2010. Përveç kësaj, shtrirja e nivelit të kamatës në mes të kredive dhe depozitave ka shënuar rritje me gati rreth 1 pikë të përqindjes në 10,9% në 2010. Të gjithë këta indikatorë kërkojnë vëmendje të kujdeshme prej institucioneve qeveritare. Kërkohet që institucionet të analizojnë nga afër dinamikën e kërkesës dhe ofertës të sektorit financiar dhe të identifikojnë ngeçjet. Këto ngeçje mund të gjenden në nivel të ofertës dhe kërkesës për financa, në infrastrukturën e tregut (financiar) dhe nivelin e shërbimeve, si dhe në nivelin e politikave, legjislationit, rregulloreve, dhe kornizave institucionale siç është sigurimi i të drejtave pronësore, zbatimi i të drejtave të kreditorëve. Në fund, institucionet qeveritare duhet të krijojnë politika si dhe të ndërmarrin veprime të nevojshme për të zgjidhur problemet kryesore dhe barrierat e politikave për të zhvilluar më tej sektorin financiar.

2. Qeverisja

2.1 Qeverisja

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
2.1.1	Qeverisja Demokratike Kombëtare (Indeksi i FH)	5.25	5.50	+0.25▼	-	-	-
2.1.2	Indeksi i Demokratizimit (UNDP)	N/A	N/A	N/A	0.92	N/A	-
2.1.3	Vlerësimi i Demokracisë (FH)	5.11	5.07	-0.03▼	-	-	-
2.1.4	Efektiviteti i Qeverisë (Indeksi i BB)	-0.74	-0.5	-0.24▲	-	-	-
2.1.5	Mallrat dhe Shërbimet nga Zyra e Kryeministrit ('000 Euro)	€3,476	€2,765	- €711▲	€4,021 (3/4 of 2010)	+ €1,256	▼
2.1.6	Punonjësit në Zyrën e Kryeministrit (numri)	289	463	+174▼	478	+15	▼
2.1.7	Shërbimi civil (numri)	75,474	78,673	+3,199 (4.2%)▼	78,695 (20,659)	+23	=
2.1.8	Kënaqshmëria me Qeverinë (%)	47/49/57 Mes. 51%	38/53/56 Mes. 49%	Mes.-2%◀▶	31/29/25 Mes. 28%	Mes. -21%	▼
2.1.9	Kënaqshmëria me Kryetarin (%)	73/69/70 Mes. 71%	47/61/61 Mes. 56%	Mes.-15% ▼	58/55/31 Mes. 48%	Mes. -8%	▼
2.1.10	Kënaqshmëria me Kryeministrin (%)	71/63/63 Mes.66%	40/53/52 Mes.48%	Mes. -18% ▼	42/36/30 Mes. 36%	Mes. -12%	▼

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – Burimet/komentet të kësaj tablele gjenden në faqen 79.

Nota e Përgjithshme: Përkeqësim (▼)

2.2 Kuvendi i Kosovës

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
2.2.1	Perceptimi i Korrupsionit në Kuvend (Indeksi i TI)	3.5	3.4	-0.1▲	3.9	+0.5	▼
2.2.2	Kënaqshmëria publike me Kuvendin (%)	46-49% Mes. 47.5%	53-46% Mes. 49.5%	Mes. +2%◀▶	34%	Mes. -15.5%	▼
2.2.3	Kënaqshmëria me Kryetarin e Kuvendit (%)	35/33/37 Mes. 35%	33/52/49 Mes. 45%	Mes. +10% ▲	40/36/33 Mes. 36%	Mes. -9%	▼
2.2.4	Buxheti i Kuvendit (`000 Euro) Përqindje e buxhetit kombëtar Buxheti i shpenzuar	€8,662 0.84% 87%	€9,622 0.83% 85%	€960▲ -0.01% = -2%▼	€9,761 0.87% 88%	€139 +0.04% +3%	= ▲ ▲
2.2.5	Buxheti për Komisionet Parlamentare Euro % i shpenzuar	N/A	€100,000 0%	N/A	€100,000 22.9%	0 +22.9%	= ▲
2.2.6	Seancat Parlamentare (numri)	44	27	-17 (-39%) ▼	34	+7	▲
2.2.7	Vijueshmëria e deputetëve në seanca parlamentare Mesatarja nga 120 Përqindja	99.5 83%	99 82.5%	-0.5 -0.5% ▼	109 91%	+10 +8.5%	▲

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – [Burimet/komentet të kësaj tablele gjenden në faqen 80.](#)

Nota e Përgjithshme: Konstant (=)

2.3 Legjislacioni dhe Mbikëqyrja nga Kuvendi

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
2.3.1	Aftësia për të mbikëqyrur legjislacionin (Raporti i Progresit KE)	Mungesë e kapaciteteve	Nevojë për përmirësim	▲	Nevojë për me tepër përmirësim	Asnjë	=
2.3.2	Miratimi i ligjeve Objektivi (nr) Miratuar (nr) Miratuar si % e objektivit	121 92 76%	135 19 16%	+14▲ -73▼ -60% ▼	169 71 47%	+34 +52 +31%	▲ ▲ ▲
2.3.3	Ligjet e kthyera për plotësim dhe ndryshim (nr)	N/A	21	N/A	35	+14	▼
2.3.4	Ligjet e monitoruara nga Kuvendi i Kosovës (nr)	11	2	-9 ▼	1	-1	▼
2.3.5	Interpelanca (nr)	3	0	-3 ▼	1	+1	▲
2.3.6	Dëgjime Publike legjislative (nr)	N/A	24	N/A	24	0	=
2.3.7	Pyetje parlamentare (nr)	250	224	-26 (-10%) ▼	300	+76	▲

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – [Burimet/komentet të kësaj tablele gjenden në faqen 81.](#)

Nota e Përgjithshme: Përkeqësim (▼)

2.4 Administrimi dhe Integriteti i Zgjedhjeve

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
2.4.1	Nota e Procesit Elektoral (Indeksi i FH)	4.5	4.5	0 =	4.25	-0.25	▼
2.4.2	Kapacitetet e KQZ-së (Raporti i Progresit KE)	Të kufizuara	Të kufizuara	none	Të kufizuara	none	=
2.4.3	Dalja në zgjedhje kombëtare (%)	49.5% (2004)	40.1% (2007)	-9.4% ▼	45.3%	+5.2%	▲
2.4.4	Dalja në zgjedhjet lokale (%)	(2007)	(2009)				
a.	Kuvende Komunale	39.4%	45.4%	+3.9% ▲	N/A	N/A	N/A
b.	Kryetar Komune	39.5%	44.7%	+5.2% ▲			
2.4.5	Vota me kusht (nr)	(2007)	(2009)		(2010)		
	Numri total	33,791	23,377	-10,414	26,321	+2,944	▼
	Si % e votës totale	5.4%	1.5%	-3.9% ▲	1.6%	+0.1%	
2.4.6	Vota të pavlefshme (% e totalit)	(2007)2.1%	(2009)7.6%	+5.5% ▼	4.2%	-3.4%	▲
2.4.7	Vëzhgues (nr)	27,000	19,576	- 7,426 ▼	31,273	+11,697	▲
2.4.8	Buxheti i KQZ-së në kohë zgjedhesh	-	€8,335,434	N/A	€6,692,090	- €1,643,344	▼
2.4.9	Alokuar (€ `000)	-	€7,781,698	N/A	€4,568,730	-€3,212,968	▼
2.4.10	Shpenzuar (€ `000)	€1,345,004	-	-	€1,837,796	+ €492,792	▼
2.4.11	Kostoja e administrimit të zgjedhjeve për votues (Euro)	-	€3.9	N/A	€2.5	- €1.4	▲

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – [Burimet/komentet të kësaj table gjenden në faqen 81.](#)

Nota e Përgjithshme: Përkeqësim (▼)

2.5 Ankesat dhe Parashtrirat Zgjedhore

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
2.5.1	Buxheti i PZAP (Euro)	-	€ 197,384	N/A	€ 171,874	- € 25,510 (13%)	▼
2.5.2	Gjobat	-	€ 210,170	N/A	€ 377,450	+ € 167,280 (80%)	▼
2.5.3	Lëshuara nga PZAP (Euro)	-	€ 151,140	N/A	€ 3,000	-€ 148,140	
2.5.4	Paguara % e pagesave brenda afatit	-	72%	N/A	0.8%	99%	
	Ankesat e trajtuar nga PZAP total						
	totali	-	544	N/A	454	-90	▲
2.5.5a	(a) publikimi i raporteve financiare	-	40	N/A	-	-	N/A
2.5.5b	(b) kërcënime dhe frikësime gjatë procesit zgjedhor	-	50	N/A	33	-17	▲
2.5.5c	(c) dyshime të parregullsisve gjatë procesit zgjedhor	-	292	N/A	121	-171	▲
2.5.5d	(d) përfunduar me gjoba	-	64	N/A	105	41	▲
2.5.5e	(e) përfunduar me rivotim	-	42	N/A	24	-18	▼
2.5.5f	(f) rinumërim/anulim i qendrave të votimit	N/A	9	N/A	94	+85	▼
2.5.6	Rastet e dorëzuara tek Prokurori (nr)	-	89	N/A	198	+109	▼

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – [Burimet/komentet të kësaj tableje gjenden në faqen 82.](#)

Nota e Përgjithshme: Përkeqësim (▼)

2.6 Partitë Politike

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
2.6.1	Fondi i Demokratizimit (Euro)	€1,913,783	€1,911,783	- €2,000 (-0.1%) ▲	€1,901,783	- €10,000	=
2.6.2	Partitë parlamentare (nr)	(2004-2007)	(2008-2010)		(2011)		
	Total	18	12	-6	8	-4	?
	Serbe	1	1	0 =	2	+1	
2.6.3	Partitë politike të regjistruara (nr)	40	-	N/A	58	+18	▲
2.6.4	Partitë politike që kandiduan për zgjedhje nacionale (nr)	-	72	N/A	29	-43	▼
2.6.5	Partitë politike që nuk u lejuan të garojnë sërish (nr)	2	9	+ 7 ▲	3	-4	▲
2.6.6	Korrupsioni në partitë politike (Indeksi i TI)	3.8	3.8	0=	4.2	+0.4	▼
2.6.7	Pjesëmarrja në aktivitetet e partive politike (%) (UNDP)	N/A	N/A	-	15.5%	-	-

Performanca (P) : Përmirësim (▲); Konstant (=); Ndryshueshëm (◀▶); Përkeqësim (▼) – Burimet/komentet të kësaj tablele gjenden në faqen 83.

Nota e Përgjithshme: Konstant (=)

2.7 Qeverisja Lokale dhe Decentralizimi

Nr	Indikatorët	2008	2009	Dallimi ('08-'09)	2010	Dallimi ('09-'10)	P
2.7.1	Qeverisja lokale demokratike (Indeks FH)	5.25	5.00	-0.25 ▼	-	-	-
2.7.2	Mbledhje e mbajtura nga Kuvendet Komunale Të rregullta	310	222	-88 ▼	345	+123	▲
2.7.3		Të jashtëzakonshme	-	24	N/A	37	+13
2.7.4	Vendimet e Kuvendeve Komunale (nr)	-	773	N/A	1,084	+311	▲
2.7.5	Rregullore të miratuara nga Kuvendet Komunale (nr)	93	107	+14 ▲	145	+38	▲
